

# FINANCA

Ditari Mujor | Mars 2024

## Standard & Poor's përmirëson për herë të parë vlerësimin për Shqipërinë në "BB-"

Në raportin më të fundit të publikuar më 22 Mars 2024, agjencia e vlerësimit të kreditit "Standard & Poors" ka përmirësuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "BB-" nga "B+", duke theksuar përmirësimin e pozicionit fiskal dhe pozicionit të jashtëm të vendit. Ky përmirësim i vlerësimit vjen si një njohje e qëndrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë dhe menaxhimit të matur të financave publike në përballje me një sërë sfidash të njëpasnjëshme. Agjencia vlerëson se ekonomia e Shqipërisë është rritur me një mesatare mbresëlënëse prej 5.8% në vit gjatë tre viteve të fundit, duke përmirësuar njëkohësisht parametrat e financave publike. Agjencia ia atribuon këtë qëndrueshmëri ekonomike, pjesërisht, një rritjeje të konsiderueshme të turizmit, duke vlerësuar se ky bum në sektorin e turizmit ndihmoi Shqipërinë të rrisë eksportet e shërbimeve me afro 15% të PBB-së midis viteve 2019 dhe 2023, duke forcur ndjeshëm pozicionin e saj të jashtëm.

▶ LEXO MË SHUMË



## Ministri Mete merr pjesë në Forumin e CEO-ve të "Dhomës Amerikane të Tregtisë"

Ministri i Financave mori pjesë në Forumin CEO-ve të Dhomës Amerikane të Tregtisë (AmCham), ku vlerësoi rëndësinë e komunikimit me biznesin në funksion të gjetjes së zgjidhjeve për çështje që prekin atë, sidomos sa i përket aspekteve fiskale. Gjatë fjalës së tij, Ministri theksoi se treguesit makroekonomikë janë përmirësuar ndjeshëm, ku turizmi gjatë vitit të kaluar solli rreth 4.2 miliardë euro të hyra në ekonomi, 47% më shumë krahasuar me vitin 2022; investimet e huaja arritën në nivelin më të lartë historik në vitin 2023, prej afro 1.5 miliardë euro; ndërsa detyrimet e prapambetura, në dhjetor 2023, zbritën në nivelin më të ulët që nga nisja e monitorimeve nga Ministria e Financave në vitin 2016, në afro 1% të totalit të shpenzimeve, në një kohë që nuk rezultoi asnjë detyrim i prapambetur sa i përket rimbursimit të TVSH-së për bizneset.

▶ LEXO MË SHUMË



## Ministri Mete në mbledhjen e KEK, diskutohen politikat në mbështetje të ekonomisë

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Kombëtar, ku u diskutua mbi politikat që qeveria po ndërmerr për të mbështetur më tej ekonominë dhe biznesin. Ministri theksoi faktin se vendi po kalon në një moment të mirë ekonomik, vlerësuar edhe nga agjencia ndërkombëtare si Standard&Poor's, i cili duhet të përkthehet në mbështetje të shtuar për sektorë dhe për shtresa të caktuara, me logjikën e një rritje ekonomike sa më gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, Ministri veçoi instrumentin e Garancisë Sovrane për sektorin fason që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave së shpejti dhe që do të jetë me terma më pozitivë dhe lehtësues se sa garancitë sovrane që qeveria ka ndërmarrë në vitet e fundit. Edhe vijimi i rritjes së pagave në sektorin publik, tha Ministri, synon që momentin e mirë ekonomik ta përkthejë në më tepër mirëqenie dhe mbështetje, si dhe të jetë shtysë për rritjen e pagave edhe për sektorin privat.

▶ LEXO MË SHUMË

## Ministri Mete: Rritja e vlerësimit nga "Standard & Poor's" përmirëson pozitat e Shqipërisë

Ministri i Financave, Ervin Mete, dha një deklaratë për mediat mbi rritjen e vlerësimit të Shqipërisë nga "Standard & Poor's", ku u shpreh se kjo rritje është një vlerësim i përpjekjeve të qeverisë shqiptare për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, forcimin e financave publike dhe efektivitetin e politikave strukturore. Ministri theksoi se rritja e vlerësimit nga Standard & Poor's forcon pozitat e jashtme të Shqipërisë dhe sjell përfitime konkrete për ekonominë e vendit, pasi tani vendi do të perceptohet më pozitivisht nga investitorët e huaj për të investuar në Shqipëri dhe kjo pritet të përkthehet në investime të huaja më të larta, si edhe kushte më të lehtësuara për huamarrjen e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare. Po ashtu, sipas Ministrit, ky përmirësim pritet po ashtu të reflektohet dhe në tregun vendas, në kosto më të ulëta të financimit për bankat, bizneset dhe individët.

▶ LEXO MË SHUMË



## Kuvendi miraton aktin normativ të ndryshimit të Buxhetit 2024

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare aktin normativ të ndryshimit të Buxhetit të vitit 2024. Në prezantimin e tij para deputetëve, Ministri i Financave tha se akti reflekton ndryshimet e nevojshme në buxhet në kuadër të riorganizimit të ministrive dhe realizon disa ndryshime sa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve, për të reflektuar rritje të të ardhurave dhe optimizim të shpenzimeve, duke ulur në të njëjtën kohë deficitin buxhetor. Ministri theksoi faktin se ekonomia ka pasur një performancë shumë të mirë gjatë vitit 2023, e cila po vijon edhe

në muajt e parë të vitit 2024, e bazuar në këto zhvillime të ardhurat për vitin 2024 janë rishikuar në rritje, në nivelin e 28.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Përmes këtij akti, tha Ministri, mbështetet Instrumenti i Garancisë Shtetërore prej 4 miliardë lekë për bizneset e sektorit të industrisë përpunuese fason, ndërsa Buxheti 2024 do të vijojë mbështetjen për një rritje domethënëse të pagave, duke bërë të mundur që brenda vitit 2024 të realizohet objektivi i vendosur për një nivel page mesatare prej 900 euro në muaj.



▶ LEXO MË SHUMË



## Performanca Paraprake e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për Janar-Shkurt 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për muajin Janar-Shkurt 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Shkurt 2024, u realizuan në masën 104.9% të planit të së njëjtës

periudhë. Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën 2 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 83.3 miliardë lekë me një realizim në masën 92.2 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 14 përqind më i lartë ose rreth 10.2 miliardë lekë më shumë. Niveli i suficitit në periudhën 2 mujore të vitit 2024 rezultoi në rreth 20.7 miliardë lekë.

▶ LEXO MË SHUMË



## Ministri Mete me përfaqësues të BB, bisedime mbi rritjen e mbështetjes për kapitalin njerëzor

Ministri i Financave, Ervin Mete, zhvilloi një takim me Drejtorin Rajonal të Bankës Botërore, z. Michal Rutkowski, Menaxherin për Shqipërinë, z. Emanuel Salinas dhe përfaqësues të tjerë të lartë të BB. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi në drejtim të mbështetjes që Banka Botërore synon të japë në lidhje me punësimin, aftësimin, rritjen e përfshirjes sociale, si edhe investimin në kapitalin njerëzor. Palët vlerësuan rëndësinë e avancimit të dialogut, si edhe analizimit të komponentëve të mbrojtjes sociale, ku Banka Botërore shprehu gatishmërinë për të ofruar asistencën e saj. Disa nga fushat ku pritet të fokusohet bashkëpunimi në të ardhmen janë përmirësimi i aftësive të të rriturve në moshë pune, duke i ofruar atyre trajnime dhe shërbime të punësimit.

▶ LEXO MË SHUMË